



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

Raport monitorues 18-të

mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit

Dhjetor 2018

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 3
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit	Faqe 4
Përmbledhje ekzekutive	Faqe 4
Dinamika e punës së Kuvendit	Faqe 7
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2018:	Faqe 7
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2018:	Faqe 8
Trendi i Diskutimeve	Faqe 10
Pyetjet parlamentare dhe çështjet e ngritura nga Kuvendarët	Faqe 14

Lista e tabelave:

Tabela krahasuese 1: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2018	Faqe 7
Tabela 2: Pjesëmarrja e Kuvendarëve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	Faqe 10
Tabela 3: Renditja e Kuvendarëve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit	Faqe 12
Tabela 4: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit	Faqe 12
Tabela krahasuese 5: Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave	Faqe 13
Tabela krahasuese 6: Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Faqe 14
Tabela krahasuese 7: Pyetjet parlamentare	Faqe 14
Tabela krahasuese 8: Inicimi i çështjeve	Faqe 14

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit	Faqe 7
Grafiku 2. Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave	Faqe 13
Grafiku 3. Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Faqe 14
Grafiku 4. Pyetjet parlamentare	Faqe 14

LISTA E SHKURTESAVE

AAK -	Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës
AKR -	Aleanca Kosova e re
KK -	Kuvendi Komunal
KPF -	Komiteti për politikë dhe Financa
KQZ -	Komisioni Qendror Zgjedhor
LDK -	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV -	Lëvizja Vetëvendosje
OJQ -	Organizata Jo- Qeveritare
PDK -	Partia Demokratike e Kosovës
Yahr -	Youth Association for Human Rights / Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut
ZKA –	Zyra Kombëtare e Auditimit

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2017/2021 dhe do të dal me raporte monitoruese-vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit.



Raporti të tetëmbëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, karakterizohet me zhvillime në interes të qytetareve. Me gjithë atë YAHR-i është munduar që të hartojë një raport, duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi
Drejtör ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Qershor - Dhjetor 2018. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Në legjislaturën 2017/2021 Kuvendi Komunal i Lipjanit nuk ka formuar asnjë komitet jo obligues apo konsultativ, me arsyetim të mos zgjidhjes së problemit me pagesa të anëtareve të këtyre komiteteve jo obliguese gjatë legjislaturës së kaluar. Andaj, në këtë legjislaturë kuvendarët lipjanas kanë vendosur që të kenë vetëm dy komitete obliguese, ai për Politikë dhe Financa dhe ai për Komunitete, pasi që e kanë problemin e zgjidhur me pagesën e mëditje për anëtarët e tyre. Kuvendarët lipjanas përveç pjesëmarrjes nëpër seanca plenare, nuk kanë shprehur interesim të marrin pjesë edhe në aktivitete tjera, si që janë debatet me qytetarë, dëgjimet buxhetore të organizuara nga ekzekutivi apo edhe nga shoqëria civile. Në katërmbëdhjetë Dëgjime buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2019/2021 të organizuara nga ekzekutivi i komunës së Lipjanit thuajse nuk ka marrë pjesë askush prej

kuvendaret. Po ashtu Dëgjimi Buxhetor i organizuar me datën 29 Gusht 2018, i cili ishte paraparë ekskluzivisht vetëm për kuvendarët dhe përfaqësuesit e komiteteve obliguese ku qëllimi i këtyre takimeve ishte diskutime për planifikimet buxhetore të komunës, dështon për shkak të mos pjesëmarrjes së tyre. Veprimet e tyre janë joserioze, me mos përgjegjësi dhe jo llogaridhënës ndaj qytetarëve .

- ✓ Gjatë viti 2018, Kuvendi i komunës së Lipjanit ka mbajtur dhjetë seanca plenare. Nëse bëjmë një krahasim me vitet paraprake kemi një dinamikë të theksuar të punës së këtij kuvendi, ku gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 47 vendime të propozuara nga ana e ekzekutivit, gjegjësisht 6 vendime me shumë krahasuar me vitin 2017 dhe janë shqyrtuar 13 raporte apo informata nga ana e ekzekutivit, gjegjësisht 3 raporte me shumë krahasuar me vitin 2017.
- ✓ Gjatë kësaj periudhe kuvendi është ballafaquar me dorëheqjet e shumta të kuvendareve, për shkaqe të konflikteve të interesit dhe të punësimeve të ndryshme nëpër institucione. Por, nga muaji maji i këtij viti është krijuar një problemi si pasojë e mos funksionimit të institucioneve në nivel qendror, pra të KQZ-së. Me 21 Maj 2018, Kuvendari Diamant Bytyqi ka dhënë dorëheqje nga mandatet si anëtar të Kuvendit të Komunës të Lipjanit dhe për këtë e ka njoftuar KQZ-në. Ku mbështetur në nenin 10 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, KQZ-ja ka qenë e obliguar ta zëvendësohen me anëtar të rinj, të cilët janë kandidat të radhës që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik të tyre. KQZ-ja nuk e ka bërë ndryshimin akoma, meqë nuk është funksionale për shkak të mos emërimit të anëtarëve të këtij institucioni nga ana e shefit të shtetit. Po ashtu edhe kuvendarja Linda Shahini nga radhët e LDK-së ka dhënë dorëheqje për shkak të punësimit në ekzekutivin e komunës si zyrtare për integritet evropiane, edhe ajo nuk është zëvendësuar me kandidaten e radhës që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik të tyre. Tani subjekti politik LDK ka mbetur pa dy mandate përfaqësuese në Kuvendin Komunal dhe kuvendi është duke funksionuar me 29 kuvendarë nga 31 sa është paraparë që të jetë.
- ✓ Organizata YAHR gjatë kësaj periudhe po ashtu ka bërë notimin e angazhimeve të Kuvendarëve dhe të subjekteve politike në fusha të ndryshme duke përfshirë: diskutimet gjatë seancave, propozime për rend dite, pjesëmarrjen e Kuvendarëve në seanca, iniciimin e çështjeve në interes të qytetareve dhe parashtrimin e pyetjeve të ndryshme nga ana e Kuvendarëve drejtuar ekzekutivit.
- ✓ Si zakonisht subjektet politike nga opozita kanë qenë më të zëshëm në diskutime gjatë periudhës Qershor – Dhjetor 2018. Ku prin subjekti politik PDK me 34.23 % me pjesëmarrje në diskutime, LVV me 22.82 %, LDK me 12.75 %, AAK me 14.77 %, AKR me 8.72 %, NISMA me 4.03% dhe PD me 2.68%.
- ✓ Gjatë kësaj periudhe kemi mbi 58 pyetje dhe çështje të ngritura për problemet të qytetarëve nga ana e kuvendareve, ku po ashtu prin subjektet politike opozitare. Tri subjekti politik të para që më së shumti që kanë bërë pyetje parlamentare janë PDK-ja me 50 %, LVV me 25.86 % dhe AAK-ja me 13.79 %, pastaj vijnë LDK-ja me 5.17 %, PD-ja me 3.45 %, dhe PAI me 1.72 % etj.
- ✓ Ndërsa, performancë më të mirë në diskutimet individuale kanë kuvendarët nga opozita, ku prin Lulzim Rrustemi nga PDK-ja 89 pikë, Selatin Retkoceri LVV (është i deklaruar si kuvendar i pavarur) me 85 pikë dhe Ramiz Qirriqi nga PDK-ja me 82 pikë,

- ✓ Gjatë kësaj periudhe kemi një pjesëmarrje aktive të kuvendarëve gra në diskutime për çështje të ndryshme. Ku më aktivja në diskutime është Kuvendarëtja nga subjekti politik LVV-ës Albulena Kelmendi ,pasuar nga Lumturije Bytyqi Hasani PDK-ë me 62 pikë dhe Hyra Bytyçi LDK 38 pikë.
- ✓ Edhe gjatë kësaj periudhe kemi edhe 6 Kuvendarët memecë të cilët nuk kanë marrë fare pjesë në diskutime në katër seancat plenare Naim Stullca, Mehmetali Krasniqi, Fadil Sopa dhe Ramadush Tasholli nga LDK-ja, Hajdin Bytyqi nga AKR-ja dhe Manush Shamolli nga NISMA.

Rekomandimet:

- ✓ Roli i kuvendareve është që ti dëgjojnë hallet dhe problemet e qytetareve si të zgjedhurit e tyre dhe këto problem ti transmetojnë tek institucionet lokale apo qendrore për ti zgjidhur ato. Kuvendarët duhen të jenë aktiv, të përgjegjshëm dhe llogaridhënës ndaj elektoratit të tyre dhe pozitën e tyre duhet ta shohin si detyrë të shenjë dhe me përgjegjësi, e jo si një vend pune! Ata duhen të jenë aktiv gjatë gjithë muajit, e jo vetëm një ditë në muaj dhe atë vetëm kur ka ndonjë seancë plenare të Kuvendit.
- ✓ Një qasje konstruktive të kryesuesit të organit të Kuvendit Komunal ndaj të zgjedhurve të qytetareve,
- ✓ Një përgjegjësi më të madhe të Kuvendarëve ndaj interesave të qytetareve dhe të mos harrohet se ata janë aty për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, e jo interesat individuale apo edhe partiake.
- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e Kuvendarëve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.
- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit


Në këtë vit 2018 deri me tani janë mbajtur një seanca e rregull plenare dhe një e jashtëzakonshëm.. Ndërsa, po ashtu është mbajtur vetëm dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është një gjendje e mirë e punës.

Tabela krahasuese 1: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2018

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit

Raporte të shqyrtuara			Rregullore dhe plane komunale të miratuara			Vendime komunale të miratuara		
2015	2016	2018	2015	2016	2018	2015	2016	2018
5	10	13	5	7	8	24	41	47

Grafiku 1. Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit



Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2018:

- Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr. 011-70915 e datës 28. 12. 2016
- Rregullorja mbi transparencën.
- Informatë mbi gjendjen e sigurisë nga Policia e Kosovës të Lipjanit për vitin 2017,

- Raporti i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2017 për Komunën e Lipjanit ,
- Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.
- Informatë mbi lokalet afariste që janë në pronësi të Komunës së Lipjanit.
- Raporti i punës i zyrës së Kryetarit dhe i drejtorëve komunale për vitin 2017
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.011-17239 të datës 05.04.2016
- *Rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët.*
- *Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2018,*
- *Rregullore mbi taksën administrave për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e ifrastrukturës,.*
- *Korniza afatmesme buxhetore e Komunës së Lipjanit 2019-2021*
- *Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2018*
- *Informatë rreth testit të Arritshmërisë dhe Testit të Maturës-afati Qershorit 2018*
- *Raportit të Auditorit të Pavarur të Kosovës për pasqyrat financiare për vitin 2017 të Komunës së Lipjanit.*
- *Raporti gjashtëmuor Qershor - Dhjetor 2018 i punës së zyrë së Kryetarit dhe drejtorateve komunale,*
- *Raporti i shpenzimeve dhe te hyrave Janar-Shtator 2018*
- *Informatë mbi gjendjen e pronave komunale në ZK. Konjuh që janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë*
- *Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019.*
- *Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre*
- *Informatë pune nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën Janar-Shtator 2018.*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2018:

- *Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtëshme të Komunës,*
- *Vendim per dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në Lipjan,*
- *Vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.*
- *Vendim për caktimin e lokacioneve për deponimin e mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e tyre dhe groposjen e kafshëve të ngordhura.*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2016 dhe 2017 në vitin 2018.*
- *Vendim për fillimin e procedurave për ndarjen e banesave në pronësi të Komunës sipas programit komunal tre vjeçar për banim 2016-2019.*
- *Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.*
- *Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë P-71409044-00846-10 nga P.SH shkolla bujqësore Lipjan në P.SH Kuvendi Komunal Lipjan për ndërtimin e tregut të gjelbër.*
- *Vendim për miratimin e planit të veprimtimit për transparencë në Komunë,*

- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e segmentit rrugor “Bejtush Gërbeshi” në kuadër të zonës urbane lindore “ZUL-5” në Lipjan,
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë,
- Vendim për miratimin e nismës bashkisë së Frascineto nga Italia për binjakëzim ndërmjet komunave të Italisë Civita dhe Frascineto me komunat e Republikës së Kosovës Lipjanit dhe Fushë Kosovës.
- Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit mbi vendosjen e bashkëpunimit komunal Ndërkombëtar,
- Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale.
- *Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për hartimin e projektit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2018-2023 1Nr. 011-21737 të datës 10. 04. 2018*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan 1Nr.400-21581 të datës 10. 04. 2018.*
- *Vendim për fillimin e aktiviteteve për organizimin dhe mbajtjen e festivalit për fëmijë, me titull “ Lipjani Këndon”*
- *Vendim për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit të Lipjanit,*
- *Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësim të paluajtshmerisë për hapjen-ndërtimin e rrugëve “Bejtush Gërbeshi” dhe “Qamil Olluri” në Lipjan.*
- *Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi.*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme (lokaleve) të Komunës*
- *Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës.*
- *Vendim për shpallje Z. Gani Demir Retkoceri qytetarë nderi i Komunës së Lipjanit,*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme komunale,*
- *Vendim për shkëputje të kontratës 1-464-3593 të datës 11.08.2011 për dhënien me qira të lokalit paluajtshmerisë.*
- *Vendim për shpalljen e z.Gani Demir Retkoceri, qytetar nderi i Komunës së Lipjanit*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës*
- *Vendim për shkëputjen e kontratës 1-464-3593 të datës 11.08.2011 për dhënien me qira të lokalit-paluajtshmerisë*
- *Vendim për pezullimin e përkohëshëm të vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi.*
- *Vendim për caktimin e lokacioneve për vendosjen e tregut të kafshëve dhe vendosjen e tregut për produktet ushqimore për kafshë,lëndë djegëse në ZK. Grackë e Vjetër.*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, kompanisë regjionale Pastrimi-Prishtinë, njësia operative në Lipjan*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim të stadiumit të futbollit “Sami Kelmendi” në Lipjan.*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan*
- *Vendim mbi ridestinimin dhe transferin e mjeteve te buxhetit per vitin 2018*
- *Vendim mbi aprovimin e Buxhetit për vitet 2019-2021*

- Vendim për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit për komunën mike për fëmijë (2018-2021)
- Vendim për ndërrimin e destinimit të tokë
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan
- Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës
- Vendim për miratimin e planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2019
- Vendim për zëvendësimin e anëtares së komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
- Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
- Vendim për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit.
- Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 9-12, në bazë të fletë-notimit për se cilin Kuvendarët:

- Vërejtje: përkatësia e politike e Kuvendarëve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të Kuvendarëve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh.

Tabela 2: Pjesëmarrja e Kuvendarëve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamenti i legjislacionit	Inicimi i rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Kuvendarët	Subjekti politik										
DIAMANT BYTYQI	LDK	Ka dhanë dorëheqje nga pozita e kuvendarit									
NAIM STULLCA	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
DAUT AZEMI	LDK										
MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NEHAT TËRPEZA	LDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
FADIL SOPA	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NAIM JAHIRI	LDK	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9
RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

HYRA BYTYÇI	LDK	0	28	5	0	0	0	5	0	0	38
LINDA SHAHINI	LDK	<i>Ka dhanë dorëheqje nga pozita e kuvendarit</i>									
ANILA REÇICA LLUGIQI	LDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	0	8	2	0	0	0	0	0	0	10
LULZIM RRUSTEMI	PDK	0	44	0	20	0	0	25	0	0	89
RAMIZ QERIQI	PDK	0	52	0	0	0	0	30	0	0	82
ARGJENT TASHOLLI	PDK	0	8	0	0	0	0	30	0	0	38
NAZMI KRASNIQI	PDK	0	56	0	0	0	0	10	0	0	66
LUMTURIJE BYTYQI	PDK										
HASANI		0	32	0	0	0	0	30	0	0	62
EGZONA BYTYQI	PDK	0	12	0	0	0	0	20	0	0	32
SELATIN RETKOCERI	LVV	0	60	0	0	0	0	25	0	0	85
SHKELZEN BISLIMI	LVV	0	32	0	0	0	0	25	0	0	57
ALBULENA KERMENDI	LVV	0	44	0	0	0	0	25	0	0	69
AFRIM MIFTARI	AKR	0	48	0	0	0	0	0	0	0	48
HAJDIN BYTYQI	AKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
SAFETE AMERLLAHU	AKR	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
BASHKIM BUDAKOVA	AAK	0	24	0	0	0	0	20	0	0	44
UKË KRYEZIU	AAK	0	56	0	0	0	0	15	0	0	71
GANIMETE QERIQI	AAK	2	8	0	0	0	0	5	0	0	15
MANUSH SHAMOLLI	NISMA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
EGZONA FAZLIJA	NISMA	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
ARBEN SALIHU	PDK	0	16	0	0	0	0	10	0	0	26
FEHMI REXHEPI	PAI	0	0	0	0	0	0	5	0	0	5

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Qershor-Nëntor 2018, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.

Kuvendarët më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë: LULZIM RRUSTEMI PDK 89 PIKË, SELATIN RETKOCERI LVV 85 PIKË, RAMIZ QERIQI PDK 82 PIKË, UKË KRYEZIU AAK 71 PIKË, ALBULENA KERMENDI LVV 69 PIKË, NAZMI KRASNIQI PDK 66 PIKË, LUMTURIJE BYTYQI HASANI PDK 62 PIKË, SHKELZEN BISLIMI LVV 57 PIKË, AFRIM MIFTARI AKR 48 PIKË, BASHKIM BUDAKOVA AAK 44 PIKË, HYRA BYTYÇI LDK 38 PIKË, ARGJENT TASHOLLI PDK 38 PIKË, EGZONA BYTYQI PDK 32 PIKË, ARBEN SALIHU PD 26 PIKË, GANIMETE QERIQI AAK 15 PIKË, EGZONA FAZLIJA NISMA 12 MAJLINDA SYLEJMANI LDK 10 PIKË, NAIM JAHIRI LDK 9 PIKË, NEHAT TËRPEZA LDK 8 PIKË, ANILA REÇICA LLUGIQI LDK 8 PIKË, FEHMI REXHEPI PAI 5 PIKË dhe SAFETE AMERLLAHU AKR 4 PIKË



Kuvendarët më pasivë të ashtuquajtur “Shikues” janë: NAIM STULLCA LDK, MEHMETALI KRASNIQI LDK, FADIL SOPA LDK, RAMADUSH TASHOLLI LDK, HAJDIN BYTYQI AKR dhe MANUSH SHAMOLLI NISMA të gjithë me 0 pikë.

Tabela 3: Renditja e Kuvendarëve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit

Kuvendarët aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve

	Kuvendarëti	Subjekti politikë	pikët		Kuvendarëti	Subjekti politikë	pikët
1	LULZIM RRUSTEMI	PDK	89	16	EGZONA FAZLIJA	NISMA	12
2	SELATIN RETKOCERI	LVV	85	17	MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	10
3	RAMIZ QERIQI	PDK	82	18	NAIM JAHIRI	LDK	9
4	UKË KRYEZIU	AAK	71	19	NEHAT TËRPEZA	LDK	8
5	ALBULENA KELMENDI	LVV	69	20	ANILA REÇICA LLUGIQI	LDK	8
6	NAZMI KRASNIQI	PDK	66	21	FEHMI REXHEPI	PAI	5
7	LUMTURIJE BYTYQI HASANI	PDK	62	22	SAFETE AMERLLAHU	AKR	4
8	SHKELZEN BISLIMI	LVV	57	23	NAIM STULLCA	LDK	0
9	AFRIM MIFTARI	AKR	48	24	MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0
10	BASHKIM BUDAKOVA	AAK	44	25	FADIL SOPA	LDK	0
11	HYRA BYTYÇI	LDK	38	26	RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0
12	ARGJENT TASHOLLI	PDK	38	27	HAJDIN BYTYQI	AKR	0
13	EGZONA BYTYQI	PDK	32	28	MANUSH SHAMOLLI	NISMA	0
14	ARBEN SALIHU	PDK	26	29			
15	GANIMETE QERIQI	AAK	15	30			

Tabela 4: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit

Subjekti politik	Propozim për rend dite	rend dite		Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave		Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve		Inicimi i çështjeve dhe Pyetjet parlamentare				
LDK	0	0	%	19	12.75	%	8	100	%	3	5.17	%
PDK	0	0	%	51	34.23	%	0	0	%	29	50.00	%
LVV	0	0	%	34	22.82	%	0	0	%	15	25.86	%
AKR	0	0	%	13	8.72	%	0	0	%	0	0.00	%
AAK	1	100	%	22	14.77	%	0	0	%	8	13.79	%
NISMA	0	0	%	6	4.03	%	0	0	%	0	0.00	%
PD	0	0	%	4	2.68	%	0	0	%	2	3.45	%
PAI	0	0	%	0	0		0	0		1	1.72	

Grafiku 2. Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave




Tabela krahasuese 5: Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave



	PDK	51	34.22	%
	LVV	34	22.81	%
	AAK	22	14.76	%
	LDK	19	12.75	%
	AKR	13	8.72	%
	NISMA	6	4.02	%
	PD	4	2.68	%
	PAI	0	0	

Grafiku 3. Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve



Tabela krahasuese 6: Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve



	LDK	8	100	%
AAK		0	0	%
AKR		0	0	%
NISMA		0	0	%
PDK		0	0	%
LVV		0	0	%
PD		0	0	%
PAI		0	0	%

Grafiku 4. Pyetjet parlamentare dhe Inicimi i çështjeve




Tabela krahasuese 7: Pyetjet parlamentare dhe Inicimi i çështjeve



	PDK	29	50.00	%
LVV		15	25.86	%
AAK		8	13.79	%
LDK		3	5.17	%
PD		2	3.45	%
PAI		1	1.72	%
AKR		0	0.00	%
NISMA		0	0.00	%

Pyetjet parlamentare dhe çështjet e ngritura nga Kuvendarët gjatë periudhës raportuese:

Mbledhjes së 8-të:

Shkelzen Bislimi: Kërkoj nga Drejtoria Komunale Shëndetësisë që ambulanca në fshatin Gadime të punojë 24 orë, po ashtu pat një kërkesë për DSHP që të ketë një tabelë në rrugën Gadime-Gjilan dhe që një rrugë të ketë emrin e Fatlum Vishesellës.

Lumturije Bytyqi-Hasani: potencoi se në disa fshatra ka pasur vërshime dhe kam pritur që drejtoria përkatëse të bëjnë një raport mirëpo me sa shihet nuk ka prandaj kërkoj nga drejtoria përkatëse një raport se cilat fshatra janë përfshi, sa është shuma e dëmeve dhe a ka nda komuna ndonjë fond.

Egzona Bytyqi, ngrit qeshjen e shqetësimit të banorëve të fshatit lidhur me ZK të Kërçevës. Duke i parë punët që po bëhen aty po shihet se është një rrezik pasi që aty afër është edhe fusha e sportit kërkoj nga drejtorit përkatës që të ketë një shenjë rreziku.

Selatin Retkoceri: Ngriti çështjen e një problemi aktual, ku në të gjitha fshatrat e Lipjanit, mbeturinat dhe trotuaret ku ka një gjendje shumë të rëndë siç janë Shala, Sllovia, Rubovci, Leletiqi etj. të cilat janë shndërruar në mbeturina e sidomos kur ka të reshura është gjendja alarmante. Nëse shkon rrugës për Rubovc e sheh në të dy anët mbeturina. Po ashtu kanalizimet nëpër fshatra janë shumë keq ku në fshatin Llugaxhi në rast të vërshimeve kanalizimi bllokohet dhe kërkoj nga komuna që të marrë masa.

Ukë Kryeziu, edhe ne kërkojmë një sqarim rreth dëmeve që janë bërë nga vërshimet.

Në fshatin Sllovi është dëmtuar trotuari në një rrugë rreth 30% kërkoj nga drejtoria përkatëse të marrë masa dhe presim të bëjë riparimin.

Argjend Tasholli, parashtrori një pyetje për grupet e vërshimeve a është vizituar rruga Gadime-Vrellë dhe kush e ka përgjegjësin t'i ndaloj qytetarët të mos hedhin mbeturina në këto rrugë. Një pyetje për drejtorinë e arsimit a e ka vizituar shkollën e Gllavicës, a e ka parë në çfarë gjendje të rëndë është ku nxënësit për të hyrë në shkollë duhet të shkojnë me çizme. Pyetja tjetër është se kur do të përfundoj kanalizimi Gadime-Gllavicë?

Lulzim Rustemi, ka ngritur dy çështje, e para afër Banullës ferma e pulave është një vend që formon erëra të pakëndshme ku banorët e Lipjanit në fshatrat për rreth e kanë të pamundur në këtë kohë vere të dalin në oborr, t'i mbajnë dritaret hapur.

Çështja e dytë ishte rreth një peticioni i fshatrave Kojskë dhe Rubovc për ndryshimin e emrit të shkollës është kthyer negativ nga këshilli i shkollës, është mirë që nivelet më të larta të vendosin për këto çështje pasi që Ligji ia përcakton, që të ketë rimmërtim të shkollave dhe këtu kemi të bëjmë me një figurë të shquar si që është Januz Bajqinca.

Për zonën ekonomike amerikane qeverisja e Lipjanit a ka bërë një kërkesë ose jo pasi që është një zonë e jashtëzakonshme dhe se di Lipjani a ka aplikuar ose jo.

Albulena Kelmendi, theksoi se në seancën e kaluar Kuvendi ka marrë vendim për ndalim parkim në disa rrugë dhe unë jam e shqetësuar me këtë çështje pasi që në rrugën Hamëz Jashari përsëri shihen veturat edhe pse ka një kontroll të policisë. Çështja e dytë është në fshatin Janjevë funksionon një qendër e mjekësisë familjare, ku ministria së bashku me ambasadën kroate i kanë dhuruar këtij lokaliteti mirëpo qytetarët janë të shqetësuar pasi që autoambulanca këtyre qytetarëve kanë frikë se do t'u merret dhe presim sqarim nga drejtoresha për këtë çështje. Po ashtu fshati ankohet se nuk ka staf të mjaftueshëm të personelit mjekësorë.

Ramiz Qeriqi, pyeti se cilat janë 4 projektet që janë në hetuesi. Për drejtorin e shëndetësisë kam një propozim që me pasur një ekip të patronazhit. Po ashtu orari i punës nuk respektohet prej disa punëtorëve. Pyetja tjetër është se policia e Lipjanit në veçanti 4 polic të rinjë janë kah sillen aq keq me qytetarët sa që mezi s'presin t'i gjobitin, po ashtu edhe Komandanti i policisë nuk pranon me u taku me palë asnjëherë nuk e dijë pse a i vjen turp nga qytetarët apo ku është problemi. Po ashtu me datën 28. 05. 2018 kishte një festë të komunitetit serb te Kisha dhe këta policët që i përmenda i denojshin qytetarët.

Nazmi Krasniqi, kërkoj një raport për drejtorin e shëndetësisë dhe të arsimit. A ka njohuri DKA-ja për marrjen e ka 2-3 eurove të nxënësve për dëmet në shkolla.

Naim Jahiri, e falënderoi të gjithë sportistët e Komunës së Lipjanit si KV "Ulpiana", KF "Ulpiana", KF "Minatori", por një falënderim të veçantë kam për KF "Arbërija" dhe KB "Ulpiana" të cilët na kanë bërë krenar neve si Lipjan.

Fehmi Rexhepi, kërkoj nga Komuna e Lipjanit gjatë ndarjes së ndihmave mos të ketë diskriminim pasi që komuniteti ashkali është diskriminim dhe kërkoj që herëve tjera të jeni më të kujdesshëm po ashtu komuniteti ashkali po diskriminohet edhe gjatë kërkesave për punësim ku në disa markete janë larguar vetëm se janë të komunitetit ashkali. Po ashtu gjatë vërshimeve në fshatin Gadime komuniteti ashkali nuk është marrë parasysh.

Hyra Bytyçi, ngiti problemin e disa banor të Lipjanit dëshirojnë të dinë lidhur me qentë endacak a është bërë ndonjë zgjidhje ose jo.

Linda Shahini, shoqata e autizmit ka bërë një kërkesë për shpërngulje çka mund të bëjmë lidhur me këtë çështje.

Mbledhjes së 9-të:

Shkelzen Bislimi, ngiti problemin e fshatit Suhadoll më nuk është në administrimin e komunës së Lipjanit mirëpo fëmijët e këtij fshati mësojnë në shkollat e Lipjanit dhe kisha pyet se a ka mundësi komuna e Lipjanit t'ia siguroj transportin këtyre nxënësve. Në rrugën Llugaxhi – Rubovc (rr. Sefë Reçica) është plantacioni i cili po ndihmon në zhvillimin ekonomik të komunës mirëpo, aty është bërë prerja e asfaltit dhe po i dëmton veturat e banorëve të këtyre fshatrave dhe banorët kërkojnë që të kthehet në gjendjen e mëparshme ose do të reagojnë. Dëshiroj me pyet se a ka marrë leje nga komuna ky person? Pastaj tha se në fshatin Gadime lagja Lekaj kërkojnë të rregullohet Lumi pasi që po ju shkakton problem banorëve të kësaj lagje. Po ashtu kërkoj nga drejtorit i kulturës të bëjë ndarjen e bibliotekës nga drejtorit.

Lulzim Rustemi, kërkoj informata për zonën komerciale në Babush si qëndron, sa është investuar etj.

Sheshin “Adem Jashari” është uzurpuar nga lojërat e fëmijëve, a ka marrë leje nga komuna pasi që sheshi është i qytetarëve. Në fshatin Bujan te shkolla e fshatit po krijohet një depon e mbeturinave është mirë drejtorit e inspektionit me pas parasysh këtë çështje.

Selatin Retkoceri, theksoi se në projekt buxhetin 2019-2021 disa projekte nuk janë përfshi si që janë rruga Lipjan-Rubovc një rrugë e ngushtë e cila ka nevojë të ketë një trotuares po ashtu edhe një shteg për biçikleta e cila do të ishte në të mirën e qytetarëve, po ashtu edhe policia duhet të jetë më e angazhuar në atë rrugë pasi që vozitet shumë shpejt edhe inspektorati duhet të mobilizohet dhe të del në atë rrugë dhe të ndëshkohen ata që hedhin mbeturina. Po ashtu prerja e pakontrolluar e masës drurorë është tmerruese duhet të intervenohet sa më shpejt. Përveç në Lipjan është mirë që në disa fshatra të krijohen parqe.

Ukë Kryeziu, kam kërkesë të njoftohemi për dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet e fundit në infrastrukturë dhe ekonomi familjare të dilet me një raport. Po ashtu kam pyetje për drejtorin e arsimit në oborrin e shkollës fillore në fshatin Slllovi është duke u ndërtua diçka, me sa shihet është një operator i telefonisë vala është mirë që të ndërtohet diku tjetër jo në oborrin e shkollës pasi që oborri i shkollës nuk ka hapësirë. Është për t'u përsëritur asfaltimi i disa rrugicave në fshatin Slllovi mirëpo te stacioni në qendër të fshatit është shtrur vetëm një pjesë e asfaltit dhe pjesa tjetër është mbetur vetëm zhavorr.

Egzona Bytyqi, tha se në seancën e kaluar kam bërë kërkesë që te parku i biznesit në Qylagë të vihet shenja e rrezikut, nga drejtori përkatës kam marrë përgjigjen në seancë por Dëshiroj me pyet se sa është marrë parasysh kërkesa jonë. Çështja e dytë ka të bëjë me drejtorin e arsimit. Ne si grup kërkojmë një raport për testin e arritshmërisë të semimaturës dhe maturës për të parë se sa është cilësor niveli i arsimit.

Bashkim Budakova, parshtrori një kërkesë për lokacionin nga vijë unë Rubovc dhe Kojskë për eliminimin e rrjetit të ujësjellësit që është dëmtuar nga punë kryerësi i rrjetit të kanalizimit, kërkoj që të merren masa për eliminimin pasi që mos të vijë deri ndonjë epidemi, pasi që të reshurat e fundit kanë shkaktuar probleme në pusët – bunarët e banorëve dhe shpresoj që kërkesa të merret parasysh.

Ganimete Qeriqi, ngiti një çështje për fshatin Krojmir ku dihet se ky fshat ka marrë pjesë në të gjitha lëvizjet ku ka pasur Dëshmorë, intelektual, pjesëtarë të UÇK-së dhe duhet që të investohet në këtë fshat pasi që rinia e fshatit po e braktisin Krojmirin.

Argjend Tasholli, ka ngritur dy çështje, e para ka të bëjë me lokalet në sheshin “Adem Jashari” të cilat paguajnë për terasat në shesh e ju thoni se ende nuk është bërë pranimi teknik, a ka mundësi të lirohen nga pagesa për arsye se gjatë punimeve në shesh këto biznese janë dëmtuar. Pyetja e dytë fushat e futbollit a janë të gjitha të ndërtuara të njëjtit standard ose jo, pasi që rinia e Gadimes edhe pse I kanë dy fusha po detyrohen të shkojnë të luajnë në fshatin Babush.

Lumturije-Bytyqi-Hasani, dëshmoi se kompania “Pastrimi” ka dështuar në mirëmbajtjen e pastrimit në komunën e Lipjanit pasi që shihen çdo ditë kontejnerët e stërmbytur, do të ishte mirë që komuna të bënte presion mbi kompaninë. Çështje e dytë edhe pse sheshi i përruar që disa kohë në mungesë të kontejnerëve qytetarët po janë të detyruar t'i hedhin mbeturinat në shesh do të ishte mirë që të vihen kontejnerët. Ka një ankesë të banorëve të fshatit Shalë në rrugën “Banush Sedllari” janë dëmtuar shtyllat e ndriçimit publike a jini në dijeni për këtë çështje.

Albulena Kelmendi, ka ngritur disa çështje: çështja e kapakëve të pusëve një rrezik i madh për qytetarët Dëshiroj me pyet çka do të ndërmerri për këtë çështje dhe a i keni identifikuar këta njerëz të pa përgjegjshëm. Çështja e dytë sheshi është gjallëru mirëpo shqetësuese për qytetarët është zërimi i lartë i muzikës në orët e vona të natës ku me sa e di një unë deri në ora 11 kanë të drejtë të lëshojnë muzikë ju si inspektoriat a jeni në dijeni për këtë çështje. Shqetësimi tjetër i qytetarëve është për super marketet të cilat

po manipulojnë me çmimet po ashtu punëtorët po punojnë me orare të stërzgjatur deri në 10 orë inspektorati a ka ndërmarr diçka lidhur me këtë çështje? Në rrugën Hamëz Jashari, rruga kah restorant Marigone është bërë diçka por jo e kënaqshme ku aty vazhdojnë të parkohen veturat do të ishte mire të vendoset ndonjë shenjë ku ndalohet parkingu.

Ramiz Qeriqi, tha katër projekte që dyshohet se janë në hetuesi cilat janë ato. Çështja tjetër kanalizimi në fshatin Krojmir është thënë se do të bëhet një gropa septike dhe një banor i fshatit Krojmir e ka lëshuar vendin kur do filloj kanalizimi. Po ashtu uji i pijes në shishë të plastikës ka raste që rrin me nga një muaj në diell a keni ndërmarrë diçka për këtë çështje. Policia po i dënon qytetarët vend e pa vend veq për t'i ngrit gradat e veta mirëpo kohën e fundit ka filluar edhe t'i rrah qytetarët ku te restorant "Roma" ku me sa shihet aty policia 60% e ndihmuar rastin. Po ashtu kam një shqetësim për drejtorin Shkelzenin të cilët i kam tregu se nuk kam ema-il dhe kur të ka punuar komisioni përmes viberit ose telefonit mirëpo herën e fundit unë isha në Tiranë dhe ky më ka njoftuar vetëm 2 orë e gjysmë para fillimit të mbledhjes dhe po dyshoj që këtë po e bënë me qëllim.

Nazmi Krasniqi, ngriti dy kërkesa: për testin e maturës dhe semimaturës që është ndërpre për nxënës, ministria ka marr vendim që mësimi të vazhdoj deri të enjten, ndërsa komuna e Lipjanit e ka ndërpre mësimin të hënën. Çështja e dytë në shkollën e mesme gjimnazi nxënësve po ju kërkohen nga 2-3 euro për pastrimin e shkollës pse po bëhet kjo çështje pasi që kam pyetur disa herë e nuk kam marrë kurrfarë përgjigje.

Linda Shahini, pat një shqetësim të banorëve të fshatit Vrellë lidhur me impiantin e ujit a do të rregullohet dhe a do të ndërmarrë diçka për të.

Arben Salihu, tha se komuna e Lipjanit ka shumë dëshmorë dhe martirë dhe do të ishte mire të vendoset një pllakë përkujtimore ku do të ishin të shënuar emrat e të gjithë dëshmorëve dhe të martirëve në mënyrë që të gjithë të ndiheshin të barabartë.

Fehmi Rexhepi, në fshatin Magurë e kanë mbyllur postën dhe qytetarët janë të shqetësuar për këtë çështje pasi që nuk kanë mundësi të vijnë në Lipjan.

Hyra Bytyçi, pat një shqetësim të banorëve të fshatit Qylagë afër fushës së sportit të bëhet një shenjë e rrezikut po ashtu pajtohem edhe me Egzonën që Kërçeva paraqet një rrezik dhe të ketë edhe aty një shenjë rreziku.

Mbledhjes së 10-të:

Lulzim Rrustemi, ka ngritur dy çështje e kemi një aset për pronat te QMI-ja të cilat janë në shfrytëzim e cilat jo. Çështja tjetër tregu i kafshëve çka është bërë me atë pjesë pasi që ju keni thënë që I kemi afër procedurat. Sheshi "Adem Jashari" çdo ditë po uzurpohet, është mire të ketë konkurrencë të barabartë për të gjithë.

Shkelzen Bislimi, kërkoi të vendosen pengesa para çdo objekti shkollor. Te rreth rrotullimi te ETC-ja të vendost një trotuar pasi qytetarët nuk po munden të kalojnë, shtyllat në rrugën 4 kursi kanë filluar të dëmtohen kërkoj të intervenohet. Po ashtu të punohet funksionalizimet parku i ish të rënëve të fashizmit te shtëpia e kulturës.

Argjent Tasholli, kërkoi spërkatje për mushkonjave në qytetin e Lipjanit dhe fshatrat e Lipjanit. Pse mungojnë billboardet mire se vini diasporë. Në Gadime a keni dale t'i shihni dëmet që janë bërë gjatë vërshimeve.

Arben Salihu, pyeti se lokalet që janë dhënë për parti politike a do të ketë në të ardhmen lokale të tilla edhe për partitë tjera apo jo.

Nazmi Krasniqi, pati një shqetësim për rrugën te kisha nuk funksionon ndriçimi publik. Sa i përket vërshimeve a ka ndonjë raport për dëmet që janë shkaktuar gjatë vërshimeve.

Ramiz Qeriqi, në fshatin Sillovi rruga Agron Gashi gypat e ujit nuk janë vendosur kërkoj të intervenohet. Prapa ABE-es ka qenë një asfalt është hiq është qit një asfalt tjetër ndërsa pjesa ku banoj unë ka mbetur pa asfalt vetëm në zallë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, pyeti se komuna a ka dal me bërë ndonjë analizë të ujit sidomos nëpër fshatra të cilat nuk janë të lidhura me ujësjellës.

Albulena Kelmendi, tha se lokalet te sheshi dhe zhurma e madhe e muzikës pas orës 12 të natës nuk po respektohen, kërkoi nga inspektorati por edhe nga ju Kryetar të bëni presion më të madh ne polici për këtë çështje. Rruga te kuzhina Ari po ndërtohet diçka dhe trotuari te ajo rrugë është uzurpuar nga punë kryerësi pyes se a jini ne dijeni për këtë çështje.

Mbledhjes së 11-të:

Lulzim Rustemi, pat dy kërkesa për mbledhjen e ardhshme, një raport – informatë për drejtorinë e bujqësisë për ndarjen e multikultivatorëve për bujqit e Lipjanit. Të dimë se kush janë përfituesit e këtij projekti. Dhe kërkesa e dytë është një informatë nga drejtori i arsimit për punësim, hapje dhe shpallje të konkursit para fillimit të vitit shkollor.

Ukë Kryeziu, kërkoi nga drejtorja e arsimit zgjidhjen e problemit të transportit të nxënësve të Sllovisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ngriti një çështje, ku mbrëmë në një medium vendor kam dëgjuar se një fëmijë me sindrom daun është larguar nga çerdhja publike në Lipjan. Për arsyeje se stafi nuk po arrijnë t'i ofroj kujdes të veçantë. Po ashtu po kërkoj që ky fëmijë të kthehet te bashkë moshatarët e vetë.

Ramiz Qeriqi, pat një çështje te QKMF-ja. Në vitin e kaluar është nënshkruar një kontratë kolektive dhe nuk është zbatuar. Nuk paguhen kujdestaritë, orët e natës e tjera është mirë me na tregu pse? Po ashtu në QKMF mungojnë barnat esenciale. Po ashtu e kam përmend shumë herë punën e kazinove ku një kazino gjendet afër çerdhes. Pastaj tha se te Janjeva është mungesa e ujit na e dimë që një projekt prej CDU-së është 500 mijë euro, Dëshiroj me ditë a është duke u punuar në këtë drejtim. Po ashtu dezinfektimin nga insektet.

Egzona Bytyqi, tha se kerkoi informata se a janë marrë masa të duhura për lëndët djegëse nëpër shkolla.

Selatin Retkoceri, pat një pyetje se a po ndërmarrët diçka për aktivitetet e kërkuara nga këshilltarët, në projeksionin buxhetor nuk po shkohet në ndërtimin e shkollave të reja dhe është për t'u përshëndetë. Pastaj tha se disa shkolla që po bëhen nuk e dijnë se kujt po ua bëjmë pasi popullsia na ka ikur. Pastaj pavarësimi i disa shkollave të vogla me pak nxënës nuk është mirë sepse humbet cilësia, si për shembull shkolla e Rubovcit, shkolla "Fehmi Agani" Medvec, "Nezë Buja" në Bujan, "Rexhep Akllapi" në Akllap dhe në Gllugovc të gjitha këto shkolla i kanë më pak se 180 nxënës. Çfarë cilësie mund të ketë dhe për çfarë shpenzohet buxhet. Pse duhet të ketë drejtor koti nëpër këto shkolla. Është mirë që ky buxhet të shpenzohet diku tjetër e jo për shkolla xhuxhe. Sivjet në Rubovc po ndërtohet një shkollë moderne por kjo është dashtë të ndërtohet më herët para 10 viteve.

Pastaj pyeti se a ka ndonjë raport të drejtorin e bujqësisë për dëmet që janë shkaktuar në bujqësi dhe a do të ketë subvencione për ata që e punojnë tokën dhe jo për qiradhënësit.

Bashkim Budakova, ngiti një shqetësim nga qytetarët të bëhet kontrollimi i marketeve sepse po qarkullojnë zëra se po shitet mall me afat të skaduar.

Argjend Tasholli, ngiti disa çështje që vijnë nga qytetarët e fshatit Gadime e Ulët që të bëhet një komision për kontrollimin e ujërave të zeza, pasi që po kanë probleme rregullisht dhe pyetja ime është se a keni planifikuar të merrni ndonjë hap që të paktën të parandalohen dëmet që po u bëhen. Tjetrën pyetje kam për trotuarin i cili është ndërtuar mbi kanalin e ujërave të zeza afër lagjes Gabrica, Dërnogllava dhe Hashani si pasojë e projektit jo të menduar mirë ujërat e zeza dalin nëpër rrugë.

Mbledhjes së 12-të:

Shkelzen Bislimi, pyeti se pse kompania nga Podujeva është përzgjedhur? Kisha dëshiruar me na tregu drejtorja procedurat e tenderimit. Pastaj tha se a do të mund të futen në sistem të pagesës për mbeturina të gjithë banorët e komunës së Lipjanit. Po ashtu dëshiroj të pyes pse në fshatin Gadime një pjesë e ndriçimit punon dhe një pjesë jo.

Argjent Tasholli, tha se ura në rrugën e Shkupit është në rrezik të lartë, a keni qenë ta vizitoni pasi që banorët duhet të punojnë në arat e tyre. Çështjen tjetër e kemi kanalizimin nëpër lagje, te lagja Reçica në fshatin Gllavicë gjatë temperaturave të nxehta është gjendje e rëndë nga gropa skeptike. Po ashtu më ka ardhur një mesazh nga fshati Dobrajë në rrugën për të shkolla është dëmtuar rrjeti i kanalizimit aty afër ka banor dhe nxënësit shkojnë në shkollë dhe është rrezik të përhapet ndonjë epidemi. Kjo kërkesë ju ka dërguar edhe asambleistit të LDK-së.

Egzona Bytyqi, para dy jave është mbajtur një tryezë diskutimi nga instituti GAP sa po respektohet marrëveshja e stabilizim asociimit nga qeverisja lokale dhe dëshiroj me ditë sa është fuqizuar zyra lokale për integritet evropiane në Lipjan.

Bashkim Budakova, është një kërkesë e fshatit Rubovc me na nda një parcelë për varrezat e fshatit këtë kërkesë e kemi me shkrim të deponuar edhe te Kryetari i Komunës.

Selatin Retkoceri, para disa dite më ka ftuar shkolla e fshatit Lugaxhi pasi jam i zgjedhur Kryetar i këshillit të prindërve dhe jam i njoftuar se ka filluar një reformë nga një shtet evropian Finlanda Dëshiroj me ditë sa jemi të përgatitur për një reformë të tillë të sistemit arsimor. Pasi që kjo reformë nuk është kah zbatohet. Dëshiroj me ditë ne si ndërmarrje kaq e madhe Ministria e arsimit, nxënësit, prindërit, shoqëria civile dhe qytetarët. Duke shfletuar këtë kërrikull pashë se kjo kërrikull kërkon mësim praktik, kompjuterik, kabinetik etj. Po ashtu dëshiroj me ditë arsimtarët tanë a i kanë këto aftësi për zbatim të kësaj kërrikull pasi janë bartësit kryesor për zbatueshmerinë e reformës evropiane.

Lumturije Bytyqi-Hasani, pat një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike z. Tasholli se në fshatin Bujan ka dy deponi ilegale ku banorët po shqetësohen për ato deponi që janë afër malit dhe varrezave. Po ashtu edhe për fshatin Shalë është një deponi ilegale dëshiroj me ditë a ka komuna ndonjë marrëveshje me këto kompani sa duhet me qëndruar këto mbeturina pasi që ato po qëndrojnë një kohë të gjatë.

Lulzim Rrustemi, ka një peticion i fshatit Bregu i Zi për një deponi që do të realizohet. Juve rregullat ju obligojnë për shqyrtim të këtij peticioni. Ki obligim ligjor për shqyrtim të këtij peticioni.

Ramiz Qeriqi, është një kërkesë e qytetarëve të fshatit Krojmir për Lumin pasi që është dimër dhe Lumi është i mbyllur mundësisht me intervenimit.

Albulena Kelmendi, çështja e furnizimit me ujë në qytetin e Lipjanit disa kanë dhe disa jo po ashtu edhe nëpër fshatra kemi ankesa që uji vjen vetëm 2 herë në ditë po dëshiroj me ditë çka ka në plan të bëjë komuna.

Te ndriçimi publik disa rrugë janë ende pa ndiqmi publik po ashtu parking prapa komunës nuk ka ndriçim publik. Çështja e shkollës gjimnazi "Ulpiana" është bërë funksional qe 2 vite, ndërtuesi ka përdorur material jo cilësorë në këtë shkollë është shumë ftoftë dhe është bërë shumë e vështirë çështja e procesit mësimor dëshiroj me ditë a ka në plan komuna për eliminimin e këtyre defekteve.

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Janar - Dhjetor 2018.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar - Dhjetor 2018
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Janar - Dhjetor 2018,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar - Dhjetor 2018.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Janar - Dhjetor 2018,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

